



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS
KËSHILLI KOMBËTAR I ARKEOLOGJISË

Nr. 1692 Prot.

Tiranë, më 24.12 2018

VENDIM Nr. 275, datë 19.12.2018

Në mbështetje të *Ligjit Nr. 27/2018 "Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë"*, Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë në mbledhjen Nr. 12, datë 19.12.2018, pasi shqyrtoi relacionin e dokumentimit të gjetjeve arkeologjike rastësore në kuadër të punimeve restauruese për projektin *"Restaurim Kisha e Shën Mërisë – Peshkëpi e Sipërme"*, *Gjirokastrë*, realizuar nga Agjencia e Shërbimit Arkeologjik dhe Instituti i Arkeologjisë si dhe për përcaktimin nga KKA të venddepozitimit të tyre.

VENDOSI:

1. Të miratojë relacionin e dokumentimit të gjetjeve arkeologjike rastësore në kuadër të punimeve restauruese për projektin *"Restaurim Kisha e Shën Mërisë – Peshkëpi e Sipërme"*, *Gjirokastrë*, realizuar nga Agjencia e Shërbimit Arkeologjik dhe Instituti i Arkeologjisë.
2. Të depozitohen në Fondet e Institutit të Arkeologjisë, Tiranë, objektet e qeramikës dhe elementët arkitektonikë më përfaqësues, të zbuluar gjatë restaurimit të kishës.
3. Të realizohet studimi i objekteve të qeramikës dhe elementëve arkitektonikë më përfaqësues, nga ASHA, IA dhe IMK.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
5. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi.

KRYETAR
MIRELA KUMBARO FURXHI
MINISTRE



SEKRETAR I KKA
RUDINA ZOTO